



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2238/4 Prot.

Tiranë, më 29.09. 2025

VENDIM

Nr. 112 dt. 29.09. 2025

“PËR

**PEZULLIMIN PËRKOHËSISHT TË PROCESIT TË THIRRJES PËR
 VETËKANDIDIM PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË KËRKIMIT, PROJEKTEVE
 DHE BOTIMEVE SHKENCORE”**

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i), nenit 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26 të Statutit të UST-së, nenit 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Përhershëm, në Nivel Institucioni, të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore, nenit 17/1 dhe 23 të Rregullores për Organizmin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.09.2025

VENDOSI:

1. Pezullimin përkohësisht të procesit të thirrjes për vetëkandidim për anëtar të Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencor deri në datën 15 tetor 2025.
2. Ky Vendim i përcillet për publikim Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

